

**STATUTI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“Elite DM” SHPK**

**ZOTËRIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, SELIA**

**Neni 1**  
**Ortaku i Vetëm**

- 1.1 Shoqëria **“Elite DM” SHPK** (“Shoqëria”) themelohet në datën e këtij Statuti dhe zotërohet nga Ortaku i Vetëm i mëposhtëm :

**Z. Kevin Ndreu**, shtetas Shqiptar, lindur më 17.11.2000, në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit nr. 036550169 (referuar këtu e më poshtë si **“Ortaku i Vetëm”**).

**Neni 2**  
**Emri**

- 2.1 Emri i Shoqërisë është **“Elite DM” SHPK**.
- 2.2 Në të gjithë dokumentet, faturat, njoftimet dhe publikimet e lëshuara nga Shoqëria, pavarësisht mënyrës së dërgimit, emri i Shoqërisë duhet të paraprihet ose të ndiqet nga të dhënat e mëposhtme:
- Fjalët “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” ose “*SHPK*”;
  - Numrin unik të identifikimit (NIPT);
  - Kapitali i regjistruar dhe pjesa e paguar e kapitalit të shoqërisë;
  - Adresa e selisë së regjistruar ; dhe
  - Një shënim që Shoqëria është në likuidim, nëse është e zbatueshme.

**Neni 3**  
**Forma Ligjore**

- 3.1 Shoqëria ka formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, në përputhje me legjislacionin tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjeter ligjore në përputhje me legjislacionin shqiptar.

**Neni 4**  
**Baza Ligjore**

- 4.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në përputhje me këtë Statut, ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqërите Tregtre”, i ndryshuar (“Ligji për Shoqërите Tregtare”) dhe dispozitat e tjera të zbatueshme të legjisacionit shqiptar.

**Neni 5**  
**Kohëzgjatja e Veprimtarisë**

- 5.1 Shoqëria krijohet për një afat të pakufizuar.

**Neni 6**  
**Selia/Adresa e Regjistruar**

- 6.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Rr. “Mine Peza”, Hyrja 3, Kati 7, Tirane, Zona Kadastrale 8330, Nr Pasurie 7/168 + 3 - N18, Volumi 15, Faqe 58.
- 6.2 Administratori mund të hapë ose të mbyllë në Shqipëri adresë sekondare të Shoqërisë.
- 6.3 Ortaku i Vetëm mund të hapë ose të mbyllë agjensi, zyra përfaqësimi, degë që nuk kanë natyrën e adresave sekondare, si dhe të vendosë të ndryshojë adresën e selisë së Shoqërisë.

**Neni 7**  
**Objekti**

- 7.1 Objekti i Shoqërisë është si më poshtë:

**“Shërbime Marketingu dhe Komunikacioni”**

- 7.2 Në mënyrë që të permbushë objektin e mësipërm, Shoqëria ka të drejtë :

- Të lidhë cdo lloj kontrate apo marrëveshje me persona fizikë ose me ente private apo publike, shoqëri, qeverinë dhe organizata të huaja ose shqiptare;
- Të themelojë shoqëri të cdo lloji ose të bëhet pjesë e shoqërive shqiptare ose të huaja, shoqërise të thjeshta, dhe në lloje të ndryshme biznesesh me objekt të njejtë ose të ngashëm;
- Të themelojë degë apo agjensi në Shqipëri dhe jashtë saj;
- Të përfaqësojë biznese shqiptare ose të huaja të lidhuara me objektin e Shoqërisë;
- Të marrë ose japë hua, të pranojë garanci personale ose garanci të tjera, të marrë përsipër detyrime, të leshojë kambiale, urdhërpagesa, çeqe ose obligacione ose garanci ose tituj dhe të emetojë garanci të tjera financiare; dhe

- f) Të ndërmarrë çdo veprimtari tjeter tregtare ose veprimtari tjeter dhe të ndërmarrë çdo veprim tjeter ligjor ose transaksion që lidhet direkt ose indirekt me objektin e Shoqërisë ose që synon në mënyrë direkte apo indirekte përbushjen e objektit te Shoqërisë.
- 7.3 Shoqëria mund të kryejë në mënyrë dytësore, pra rastësore dhe në çdo rast me qëllim përbushjen e objektit te Shoqërisë, çdo veprim tregtar, industrial, operacion financiar dhe transaksione në lidhje me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme të cilat mund të gjykojnë si të nevojshme ose të përshtatshme për arritjen e objektivit të Shoqërisë.
- 7.4 Shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimet ndihmëse ose veprimet e lidhura, si dhe gjithë aktivitetet e nevojshme ose ato që konsiderohen të nevojshme për të arritur qëllimin e biznesit të Shoqërisë duke zbatuar ligjin.
- 7.5 Objekti i shoqërisë mund të modifikohet ose ndryshohet me vendim të Ortakut të Vetëm.

**Neni 8  
Kapitali**

- 8.1 Kapitali i regjistruar i Shoqërisë do të jetë 100 (njëqind) Lekë.
- 8.2 Ortaku i Vetëm është zotërues i një kuote që përfaqëson 100% të kapitalit me vlerë të përgjithshme të përcaktuar në nenin 8.1 më sipër.

**Neni 9  
Transferimi i pjesëve të kapitalit / Kufizimet për transferimin**

- 9.1 Ortaku i Vetëm është zotëruesi i vetëm i gjithë kuotës që përfaqëson kapitalin e regjistruar të Shoqërisë.
- 9.2 Kuotat e kapitalit të regjistruar mund të transferohen plotësisht ose pjesërisht tek të tretë me shkresë me shkrim.
- 9.3 Kuotat e kapitalit të regjistruar transferohen me anë të trashëgimisë pa shkresë të vecantë me shkrim.

**Neni 10  
Zmadhimi kapitalit**

- 10.1 Ortaku i Vetëm mund të zmadhojë kontributin e tij në kapitalin e regjistruar.
- 10.2 Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet edhe përmes nënshkrimit dhe emetimit të kuotave të reja prej ortakëve të rinj. Ortakët e rinj do të pranohen dhe do të miratohen si të tillë me një vendim të Ortakut të Vetëm.



**Neni 11**  
**Zvogëlimi i Kapitalit**

- 11.1 Bazuar në vendimin e Ortakut të Vetëm, zvogëlimi i kapitalit të regjistruar do të bëhet në përputhje me procedurat e parashikuara nga legjislacioni tregtar.

**STRUKTURA DREJTUESE**

**Neni 12**  
**Vendimet e Ortakut të Vetëm**

- 12.1 Vendimet kryesore të veprimtarisë së Shoqërisë miratohen me vendime të Ortakut të Vetëm i cili është organi më i lartë drejtues i Shoqërisë që ka të drejtë të miratojë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e aktiviteteve të saj. Vendimet e Ortakut të Vetëm duhet të regjistrohen në regjistrin e vendimeve të Shoqërisë, të dhënët e të cilat mund të ndryshohen apo fshihen. Për sa kohë që Shoqëria të ketë vetëm një Ortak, vendimet e Ortakut të vetëm do të janë në formën e një dokumenti të vetëm të nënshkruar nga Ortaku i Vetëm dhe nuk do të mbahet procesverbal mbledhjeje.
- 12.2 Të drejtat dhe detyrimet e Ortakut të Vetëm do të ushtrohen direkt nga përfaqësuesi i caktuar nga organi i autorizuar i Ortakut të Vetëm.
- 12.3 Vetëm Ortaku i Vetëm ka të drejtë të vendosë për çështjet e mëposhtme:
- a) modifikimet dhe ndryshimin e këtij Statuti;
  - b) pranimin e ortakëve të rinj (pas zmadhimit të kapitalit të regjistruar ose transferimit të kuotave);
  - c) të zmadhojë dhe/ose zvogëlojë kapitalin e regjistruar;
  - d) vendosë për shkrirjen, prishjen, likuidimin dhe çdo lloj transformimi tjetër të Shoqërisë;
  - e) të vendosë për përvetësimin dhe/ose në transferimin e kuotave në Shoqëri në Shqipëri apo jashtë saj;
  - f) të themelojë dhe/ose të mbyllë degë ose zyra përfaqësimi;
  - g) të miratojë pasqyrat financiare dhe bilancin vjetor, të përcaktojë buxhetin vjetor dhe të miratojë shpërndarjen e fitimeve dhe/ose përballimin e humbjeve;
  - h) të emërojë ose shkarkojë administratorin;
  - i) të vendosë mbi çështjet e vlerësimin dhe kontrollit mbi mbarëvajtjen e veprimeve;
  - j) të miratojë rregullat e brendshme të administrimit;
  - k) të ngrejë padi kundër anëtarëve të organeve të Shoqërisë;
  - l) të vendosë mbi përvetësimin, shitjen dhe vendosjen e barrës mbi pronat dhe pasuritë e tjera paluajtshme të Shoqërisë;
  - m) të prishë Shoqërinë;
  - n) të përcaktojnë pagën e administratorit;
  - o) të vendosë për emërimin e ekspertëve kontabël;
  - p) të përcaktojë organizimin administrativ dhe strukturor të Shoqërisë;



- q) të miratojë kontratat e prokurimit që tejkalojnë një të pestën e kapitalit;
- r) të miratojë punësimin, pushimin dhe çështje të tjera të punës, dmth. Promovimin, bonuset e pagës etj. që kanë lidhje me pozicionet e drejtuese të shoqërisë;
- s) të miratojë lidhjen e kontratave që janë në kushtet e konfliktit të interesit në përputhje me nenin 13 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare;
- t) të miratojë huatë ose dhënien e garancive;
- u) të vendosë për cdo çështje tjetër zgjidhja e të cilës është në kompetencën e ortakëve sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe/ose sipas këtij Statuti.

### **Article 13 Administratori**

- 13.1 Administrimi i përditshëm i Shoqërisë do t'i caktohet 1 (një) Administratori që emërohet dhe zëvendësohet nga Ortaku i Vetëm.
- 13.2 Administratori mund të ri-zgjidhet.
- 13.3 Administratori ka kompetenca të plota për administrimin e zakonshëm dhe të përditshëm të Shoqërisë dhe të drejtën për miratimin e të gjitha vendimeve që mund t'i duket e përshtatshme për të realizuar dhe ushtruar objektin e Shoqërisë, me përjashtim të veprimeve që i takojnë Ortakut të Vetëm sipas ligjit ose këtij Statuti ose sipas vendimeve të Ortakut të Vetëm, të miratuara herë pas here.
- 13.4 Administratori ka të drejtë t'i delegojë pjesërisht ose tërësisht të tretëve të gjitha të drejtat e tij, me anë të prokurës, pasi të marrë miratimin paraprak me shkrim të Ortakut të Vetëm.
- 13.5 Me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë Statut, Administratori ka të drejtat e mëposhtme:
- a. administrimin e përditshëm të veprimitarisë tregtare të Shoqërisë në përputhje me vendimet dhe udhëzimet e Ortakut të Vetëm, të miratuara herë pas here;
  - b. përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe organeve publike;
  - c. hapjen, mbylljen dhe operimin e llogarive bankare të Shoqërisë në banka;
  - d. lidhjen e marrëveshjeve me palë të treta;
  - e. lëshimin e faturave dhe pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e garancive nga palë të treta;
  - f. punësimin dhe shkarkimin e punonjësve të Shoqërisë dhe përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të tjera të punonjësve në përputhje me politikat dhe udhëzimet e miratuara herë pas here nga Ortaku i Vetëm (nëse ka);
  - g. kryerjen e gjithëve primeve të tjera të lidhura me aktivitetin e përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe e këtij Statuti;
  - h. mbajtjen e librave kontabël në përputhje me ligjin dhe parimet e kontabilitetit; dhe
  - i. përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të Shoqërisë dhe auditimin e tyre nga ekspertë kontabël të jashtëm nëse kjo kërkohet nga ligji ose me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 13.6 Administratori do të qëndrojë në detyrë për një mandat maksimal prej 5 (pesë) vjetësh, me të drejtë rizgjedhjeje, përvçeç nëse Ortaku i Vetëm do të vendosë një afat më të shkurtër ose zëvendësimin e tij



përpara përfundimit të mandatit në përputhje me ligjin. Gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, Administratori duhet të tregojë kujdesin e një personi të ndërgjegjshëm dhe të besueshëm dhe do të ruajë sekretin për cështjet konfidenciale.

13.7 Administratori do të përfaqësojë Shoqerinë dhe do të kryejë të gjitha veprimet pa kufizim dhe do të lidhë çdo marrëveshje, transaksion, ose çdo veprim tjetër që ai mund ta quajë të nevojshëm për të arritur dhe përbushur objektin e shoqërisë, me përjashtim të veprimve që ligji ose ky Statut ja rezervon Ortakut të Vetëm.

13.8 Administratori i Shoqërisë do të jetë:

**Z. Kejvin Ndreu, shtetas Shqiptar, lindur më 17.11.2000, në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit nr. 036550169 i cili caktohet si Administrator për një periudhë 5 (pesë) vjecare.**

#### **Neni 14 Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësitet**

- 14.1 Përveç detyrimeve të përgjithshme të parimit të besnikërisë parashikuar në nenin 13, 14, 15, 17 dhe 18 të Ligit shqiptar për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, administratori duhet :
- të kryejë detyrat e tij në përputhje me Ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare apo këtë Statut, me mirëbesim dhe duke marrë parasysh interesin më të mirë të Shoqërisë si e tëre;
  - të ushtrojë kompetencat e tij të përcaktuara nga Ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare apo prej këtij Stauti, vetëm për qëllimet e përcaktuara aty;
  - të shqyrtojë me përgjegjshmëri cështjet për të cilat duhet të merret vendim;
  - të parandalojë dhe shmangë konflikte aktuale apo të mundshme midis interesave të tij dhe Shoqërisë;
  - të ushtrojë detyrat e tij me kujdes dhe profesionalizëm;
  - të japë çdo informacion në lidhje me biznesin dhe të dhenat ekonomike të Shoqërisë të kërkuar nga Ortaku i Vetëm brenda një afati kohor të arsyeshëm dhe në cdo rast jo më vonë se 7 ditë. Informacioni dhe të dhënët duhet të janë të përditësuara.
- 14.2 Administratori gjatë ushtrimit të detyrave të tij do të janë përgjegjës ndaj Shoqërisë për çdo veprim apo mosveprim që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e Shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer me mirëbesim.
- 14.3 Në rast shkeljeje të detyrave dhe të standardeve profesionale të parashikuara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij nen 14, Administratori ka detyrimin të dëmshpërbleshë Shoqerinë për çdo dëm që rezulton nga kjo shkelje. Ai duhet që gjithashtu të kthejë çdo fitim personal të përfituar nga ai ose nga persona të tjera të lidhur me të, si pasojë e shkeljeve gjatë ushtrimit të detyrës. Ai do të ketë barrën e provës për të provuar përputhshmërinë e ushtrimit të detyrave të tij dhe të standardeve të këruara. Në rast se një shkelje është kryer nga më shumë se një Administrator, të gjithë Administratorët në fjalë do të përgjigjen individualisht ose bashkarisht ndaj Shoqërisë.

- 14.4 Në mënyrë të vecantë, por pa u kufizur në to, Administratori është i detyruar të dëmshpérblejnë Shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me ligjin, kryejnë veprimet e me poshtme:
- ti kthejë antarëve kontributet;
  - ti paguajë antarëve interesa apo dividentë;
  - të shpérndajë aktivet e shoqërisë;
  - të lejoj që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes së saj financiare, është e parashikueshme që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet; dhe
  - të japë kredi.
- 14.5 Neni 92, paragrafi 6 i Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, zbatohet edhe për paditë që rrjedhin nga paragrafët e këtij neni. Këto padi duhet të ngrihen brenda tre vjetëve nga kryerja e shkeljes apo nga zbulimi i saj.

**Neni 15  
Ekspert(ët) Kontabël te Shoqërisë**

- 15.1 Një ekspert(ët) Kontabël i jashtëm i Shoqërisë do të emërohet me vendim të Ortakut të Vetëm nëse është e nevojshme. Mandati i ekspertit, nëse është emëruar një i tillë, duhet të rinnovohet cdo vit.

**Neni 16  
Viti Financiar**

- 16.1 Viti financiar i aktivitetit të Shoqërisë përkon me vitin kalendarik, duke filluar në 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.

**Neni 17  
Bilanci. Kontabiliteti**

- 17.1 Bilanci i Shoqërise shqyrtohet nga Ortaku i Vetëm dhe duhet të përgatitet për t'iu paraqitur organeve tativore para përfundimit të muajit Mars të vitit vijues.
- 17.2 Librat kontabël duhet të mbahen në gjuhën shqipe dhe në monedhën vendase (lek). Shoqëria mund të mbajë llogari të veçanta në monedhë të huaj, shuma e të cilave duhet të konvertohet çdo muaj në monedhën vendase.
- 17.3 Shoqëria mund të financohet nga institucione financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këtë arsy, Shoqëria mund të vendosë si garanci pengun mbi kuotat e saj ose mund të hipotekoje pasurinë e paluajtshme të saj, me vendim të Ortakut të Vetëm.



**Neni 18**  
**Likuidimi**

- 18.1 Ortaku i Vetëm mund të vendosë të prishë Shoqërinë.
- 18.2 Me vendim të Oratkut të Vetëm do të caktohet një likuidues ose një grup likuiduesish që do të kryejnë procedurat e likuidimit.
- 18.3 Likuiduesi(it) do të përgatisin raportin e likuidimit i cili përmban një përbledhje të gjendjes financiare të shoqërisë, hapat e likuidimit dhe kohën e nevojshme për përfundimin e likuidimit. Në fund të procesit, Ortaku i Vetëm do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe do të japë miratimin për përfundimin e procedurës së likuidimit.

**Neni 19**  
**Ndryshime në Statut**

- 19.1 Dispozitat e këtij Statuti mund të ndryshohen nga Ortaku i Vetëm në përputhje me dispozitat e legjislacionit tregtar.

**Neni 20**  
**Dispozitat përfundimtare**

- 20.1 Ky Statut është hartuar në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Nënshkruar më datë 01 Gusht 2023 në Tiranë nga:

**Ortaku i Vetëm**  
**Z. Kejvin Ndreu**

*Kejvin Ndreu*

